



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 78, Datë 06.04.2018

MBI

MIRATIMIN E E MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË KA NËNSHKRUAR OSHEE SH.A ME SHOQËRINË E LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE ALBANIAN ENERGY SUPPLIER SH.P.K. (AES SH.P.K)

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 20 pika 1 të “Marreveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE Sh.a me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike "Albanian Energy Supplier" sh.p.k. (“AES” sh.p.k.)

Konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 4121 Prot., datë 05.03.2018 ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 1714 Prot., datë 29.01.2018 dhe Nr. 007 Prot., datë 30.01.2018 nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe "Albanian Energy Supplier" sh.p.k. me qëllim miratimin nga ERE në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.02.2017, "Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 96 datë 27.10.2014 ka vendosur për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për një afat 30 vjeçar.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 38, datë 18.3.2015, ka licencuar shoqërinë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike. (“AES” sh.p.k.) për një afat 5 vjeçar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 24, datë 15.02.2017, ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”.
- Në nenin 20 pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike” sanksionohet se: *“Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”*.
- Në përmbajtjen e saj, kjo marrëveshje e nënshkruar dhe dakortësuar mes palëve ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen tip të cilën e ka miratuar me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.02.2017.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të miratojë marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 1714 Prot, datë 29.01.2018 dhe nr. 007 Prot, datë 30.01.2018 nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a dhe shoqërisë Albanian Energy Supplier sh.p.k. (“AES” sh.p.k.)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.